



## LG Electronics Magyar Kft.

H-1097 Budapest, Könyves Kálmán krt. 3/a  
T. +36-1-455-60-60 F. +36-1-455-60-66 [www.lg.hu](http://www.lg.hu)

### **Afatet dhe Kushtet e promociionit "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019"**

Kushtet e tanishme të "LG 5 vite garanci" (këtej e tutje referuar si Kushtet) janë të zbatueshme për Konsumatorët të cilët kanë blerë disa frigoriferë ose rrobalarëse, siç përcaktohet në Kushtet, ndërmjet periudhes 1 Shtator – 30 Nëntor 2019 të tregtuara nga LG Electronics Magyar Kft. në territorin e Kosovës dhe të shkarkoni dokumentin 'Çertifikata 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019' në [www.lgemk-promotions.com/5-year-warranty-ha-kos-2019-vjeshte/](http://www.lgemk-promotions.com/5-year-warranty-ha-kos-2019-vjeshte/) pas blerjes.

Ju, si Konsumator, shprehimisht pranoni që Kushtet e tanishme janë të zbatueshme për fushatën "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019", dhe Ju e pranoni atë si detyrim për ju, duke kuptuar se të drejtat në lidhje me të duhet të zbatohen vetëm sipas Kushteve.

1. Bazuar në Kushtet aktuale, dokumenti që verifikon blerjen tuaj (faturë, kupon fiskal), karta e garancisë së plotësuar dhe dokumentin e shkarkuar 'Çertifikata 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019' kërkohen bashkërisht për të aplikuar për "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019" për produktin tuaj të blerë gjatë periudhës së fushatës.

2. Çështjet e caktuara dhe të përcaktuara në Kushtet nuk kanë efekt mbi të drejtat tuaja si konsumator, të zbatueshme në bazë të ligjeve dhe rregullave.

3. "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019" u jep juve të drejtat dhe përparësitë e mëposhtme:

Gjatë 5 (pesë) viteve të llogaritura nga data e blerjes fillestare të Produktit, ekziston një garanci e plotë e shprehur për të gjitha defektet që janë rezultat i gabimit të prodhimit, që do të thotë riparim pa pagesë, pjesë rezervë falas dhe riparim në vend falas, nëse nevojitet riparimi në vend. Për më tepër, kjo përfshin zëvendësimin eventual falas të Produktit, po ashtu. Nëse Produkti duhet të zëvendësohet gjatë afatit të "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019" (edhe më shumë se një herë), ju do të keni të drejtë për kushtet e garancisë ligjore të aplikueshme në kohën e zëvendësimit të Produktit ose afateve dhe kushteve të shprehura të garancisë në bazë të kushteve aktuale të aplikueshme deri në përfundimin e afatit fillestar të "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019" të Produktit tuaj të blerë fillimisht, cilado që është më e dobishme për Ju, si një konsumator.

4. "LG 5 vite garanci për frigoriferë dhe rrobalarëse, vjeshtë 2019" është e vlefshme për periudhën 5 vjeçare të llogaritur nga data e blerjes dhe duhet të zgjatet çdo herë kur Produkti është jashtë funksionit për shkak të defektit duke llogaritur periudhën kohore në të cilën ka qenë jashtë funksionit.

5. Çdo riparim ose zëvendësim do të shënohet në kartën e garancisë të lëshuar nga LGEMK gjatë periudhës 5 vjeçare.



## LG Electronics Magyar Kft.

H-1097 Budapest, Könyves Kálmán krt. 3/a  
T. +36-1-455-60-60 F. +36-1-455-60-66 www.lg.hu

### 6. Promocioni vlen për këto produkte:

Frigoriferët: GBB548GVQZE, GBB59NSGFB, GBB59PZDZS, GBB59PZFZB, GBB59PZGFS, GBB59PZJZB, GBB59PZJZS, GBB59PZRZS, GBB59SWJZB, GBB59SWJZS, GBB59SWRZS, GBB59WBJZS, GBB60MCFFS, GBB60NSFFB, GBB60PZFZS, GBB60PZGFB, GBB60PZGFS, GBB60SAYFE, GBB60SWGFS, GBF59PZDZB, GBF59PZFZB, GBF59WBDZB, GBF60NSFZB, GBP20PZCFS, GBP20PZCZS, GBB548PZCZH, GBB566PZHZN, GBB61BLHZN, GBB61BLJZN, GBB61PZGFN, GBB61PZHZN, GBB61PZJZN, GBB61SWHZN, GBB61SWJZN, GBB62PZGFN, GBB62PZJZN, GBB71PZDFN, GBB71PZDZN, GBB71PZEFN, GBB72MCDFN, GBB72MCEFN, GBB72NSDFN, GBB72PZDFN, GBB72PZDZN, GBB72PZEFN, GBB72PZEZN, GBB72SADFN, GBB72SWEFN, GBB92MCAXP, GBB92STAQP, GBF567PZCZB, GBF61BLHZN, GBF61PZJZN, GBF71PZDZN, GBF72NSDZN, GBP31DSLZN, GBP31SWLZN, GBP32DSKZN, GBP62DSNFN.

Rrobalarëset: F0J6WY0W, F0J6WY1W, F2J5NY4W, F2J6HM0W, F2J6WY0W, F2J6WY1W, F2J7HG2W, F2J7HM1W, F2J7HY1W, F2J7TY1W, F4J5VY3W, F4J6QY0W, F4J6TG0W, F4J6TG1W, F4J6TY0W, F4J6VG0W, F4J6VG1W, F4J6VY0W, F4J7FH1W, F4J7TH1W, F4J7TY0W, F4J7VY1W, F4J8FH2W, F4J8VS2W, F4J8VS2W, F4J9JH2T, F4J9JS2T, F8K5XN3, FH695BDH6N, FH6G1BCH2N, F2DV7S8H1, F2DV9S8H2, F2WN5S6S0, F2WN7S7S1, F2WV9S8P2, F4DV708H1, F4DV709H1, F4DV709H1T, F4DV909H2, F4DV910H2, F4DV910H2S, F4N509S0, F4TURBO8S, F4TURBO9S, F4WN508S0, F4WN509S0, F4WV708P1, F4WV709P1, F4WV909P2, F4WV910P2S.

7. Ju lutemi që të siguroheni gjatë blerjes se paketimi i produktit përmban kartën e garancisë të lëshuar nga LGEMK.

8. Konsumatori ka të gjitha të drejtat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (Rregullorja (EU) 2016/679) dhe Njoftimi i Përgjithshëm i Privatësisë i LGEMK, duke përfshirë - pa kufizim - të drejtën për të kërkuar qasje ose fshirje, bllokim ose korrigjim të të dhënave të tyre të përpunuara. Konsumatori mund të paraqesë kërkesa dhe deklarata në lidhje me trajtimin e të dhënave dhe veprimtarinë e përpunimit tek Zyrtaari për Mbrojtjen e të Dhënave, Jung Ryu në adresën [dpoeu@lge.com](mailto:dpoeu@lge.com) apo [adatvedelem@lge.com](mailto:adatvedelem@lge.com)

Faleminderit që keni zgjedhur Produktin tonë.

Data: 01/09/2019

LG Electronics Magyar Kft.